

## **Duke firmosur këtë dokument unë pranoj pikat e mëposhtme:**

### **POLITIKAT E KTHIMIT TE PRODUKTEVE**

1) Informacioni i shfaqur në këtë dokument është në përputhje me kërkesat e klientit duke ju referuar zgjedhjes të produkteve të rezervuara nga showroom-i apo online, pasi ka pranuar dhe pëlqyer specifikat e produktit.

2) Ju lutem ruani faturën e shitjes dhe kuponin tatimor për çdo pretendim që mund të lindë nga një defekt në produkt, një montim jo i rregullt, mungesa në pako, etj, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këtë dokument. Ne rast të kundërt kompania nuk mund të procedojë me asnjë lloj asistence ndaj klientit.

### **NËSE JU ZGJIDHNI QË MONTIMIN TA KRYENI VETË:**

3) Në rast se ju e merrni porosinë me transport falas deri në pikën më të afërt ku vjen makina ose e merrni vetë porosinë nga magazina, nëse ju konstatooni që mungojnë pjesë apo dalin të dëmtuara nga amballazhi, keni 2 ditë kohë nga tërheqja e mallit për ta reklamuar te numri i kujdesit ndaj klientit (044 53 5000), nëse reklamimi nuk bëhet brenda afatit më sipër kompania nuk mban përgjegjësi për mungesa ose për kthim/ndërrim të këtij malli.

4) Në rast se ju keni gabuar në përzgjedhjen e produkteve (shembull: në përmasa apo në ngjyrë), ju do mund ta ndërroni me një produkt me vlerë të njëjtë ose më të lartë se produkti i parë, nëse është në gjendjen fillestare dhe në kushtet për tu rishitur. Mobiljen që doni të ndërroni, ju duhet ta sillni pranë magazinës tonë në gjendjen fillestare, me paketimin përkatës si dhe faturën e shitjes bashkangjitur kuponit tatimor. Në pamundësinë tuaj për tu paraqitur pranë magazinës tonë, ne ju ofrojmë shërbimin e transportit që ofrohet nga kompania kundrejt pagesës. Tabela ne Aneksin 1. Kjo pagesë duhet të bëhet paraprakisht në një nga numrat tanë të llogarisë.

**KUJDES:** Nëse mobilja që ju ktheni, inspektohet dhe konstatimi është që nuk është në gjendje të rishitshme, pagesa e shërbimit mbahet nga kompania, dhe produkti nuk kthehet. Kthimi apo ndërrimi i mobiljes mund të iniciohet vetëm nëse ju nuk keni nisur procesin e montimit.

### **NËSE JU ZGJIDHNI TË PAGUANI PËR SHËRBIMIN E MONTIMIT:**

5) Kur produkti dorëzohet dhe montohet nga pala e tretë (transportues-montues të jashtëm) në adresën tuaj, nëse ju konstatooni defekte, apo një montim jo të rregullt, keni të drejtë të mos firmosni faturën dhe të mos likujdoni shërbimin e montimit. Kur konstatohet nga ju një problem duhet t'i kërkonti montuesit pezullimin e menjëhershëm të montimit dhe ndërkohë të kontaktoni direkt shërbimin e kujdesit ndaj klientit në numrin e telefonit që ka edhe në proformë dhe në faturë 044535000.

6) Duke ju referuar 2 pikave të mësipërme (4 DHE 5) nëse ju merrni porosinë me montim nga montuesat keni mundësinë që të kërkonti ndërrim produkti **VETËM** gjatë kohës që montuesat ndodhen ne banesë. **I lutemi cdo klienti që të kryejë inspektim të plotë të produktit nga ana estetike ashtu si dhe funksionale para se të firmosë faturën dhe montuesi të lërë banesën. Në rast të kundërt kompania nuk mban përgjegjësi për ndërrimin e mallit.**

**KUJDES:** Nëse konstatohet nga kompania se produkti ka një defekt fabrikimi dhe është brenda afateve të garancisë, do të ofrohet riparimi i pjesës që ka dëmtimin brenda afatit 2 javor.

### **BLERJET ONLINE:**

Nëse ju bëni një blerje online tek ne, nga website apo nga rrjetet sociale, kompania nuk garanton që ngjyra apo finitura e produktit që ju vjen, do jetë e njëjtë me atë që ju shihni në foto, kjo varet nga pajisja me të cilën ju e shihni foton dhe ndriçimi që ju keni. Nëse doni siguri për ngjyrën e produktit duhet të vizitoni showroomin tonë. Kështu ju do keni zgjedhjen edhe për ta kthyer produktin por kostoja e shërbimit do mbulohet nga ju si në aneksin më poshtë paraqitur në këtë dokument.

7) Për pagesa me bankë:

Afati për t'u kryer pagesa, nga momenti i rezervimit, është 5 ditë (pune). Nga momenti që kalon afati prej 5 ditësh(pune), porosia e rezervuar (e pasqyruar në një proformë) do të anulohet automatikisht nga sistemi.

8) Për pagesa me bankë ju keni detyrimin që të paguajë totalin e vlerës plus çdo komision që mund t'i detyrohet bankës. Pagesa tek llogaritë tona duhet të vijë në vlerën e plotë të porosisë.

Shënim: **Nëse pagesa nuk kryhet e plotë firmës i lind e drejta të mos e lëvrojë mallin derisa të paguhet cdo mbetje e pagesës.**

**Kujdes: Kosto e transportit dhe montimit paguhet cash në momentin e dorezimit.**

9) Nga momenti i procesimit të pagesës malli duhet lëvruar brenda 12 ditëve pune dhe ju duhet të jeni të gatshëm për të pritur mallin në banesë, pasi jeni telefonuar 1 ose 2 dite përpara nga nr fiks i shërbimit te kujdesit ndaj klientit 044535000.

Kompania ka për detyrim ta mbaj ne magazine mallin e paguar nga ju deri në 20 ditë pune.

Shënim: Kur pagesa e porosisë është kryer me bankë, afati i dorezimit nuk mund të jetë më shpejtë se 24 orë nga momenti i disbursimit të shumës. Gjithashtu nëse ju nuk përgjigjeni në telefon, dërgesa shtyhet në grupazhin e transportit të rradhës.

10) Në rast se ju nuk pranoni mallin e porositur, por keni kryer pagesën në bankë (dhe malli gjendet akoma në magazine, (i pa lëvruar) nuk do të mundësohet dot kthimi i parave, por ju mund të zgjidhni të ndryshoni porosinë për të shfrytëzuar pagesën e kryer.

Kur dërgesa vonohet më shumë se afati i rënë dakord në këtë dokument, ju lind e drejta të kërkonti kthimin e parave në llogarinë tuaj.

11) Për pagesat cash në dorëzim dhe me tërheqje të mallit direkt në magazinë afati nga dita e porosisë është 5 ditë pune. Nga momenti që kalon afati prej 5 ditësh(pune), porosia e rezervuar (e pasqyruar në një proformë) do të anulohet automatikisht nga sistemi.

12) Afatet e dërgesave për produktet e personalizuara (me porosi):

Kuzhinat shqiptare – deri në 15 ditë pune nga momenti i pagesës.

Kuzhinat italiane – deri 30-60 ditë pune nga momenti i pagesës

Kënd divani i cilësisë premium - deri në 15 ditë pune nga momenti i pagesës.

Kompania ka për detyrim ta mbaj ne magazinë mallin e paguar (porosi e personalizuar) nga ju deri në 10 ditë pune.

#### \*ANEKS 1

Per produkte me vlere fature nen 360 Euro (44,640 Leke) tarifa e kthimit eshte fikse me vlere 3,000 leke te reja.

Per vlere mbi 360 Euro tarifat e kthimit llogariten si perqindje e produktit qe do te kryhet sherbimi I kthimit sipas zonave te ndryshme si ne tabelen e meposhteme:

ZONA	ZONA 1	ZONA 2	ZONA 3	ZONA 4	ZONA 5	ZONA 6	ZONA 7
	TIRANE	ELBASAN	LAC	FIER	VLORE	KORCE	GJIROKASTER
	DURRES	F KRUJE	LIBRAZHD	DIVJAKE	SHKODER	TEPELENE	SARANDE
		KRUJE	CERRIK	LEZHE	POGRADEC	KUKES	ERSEKE
		MAMURRAS	BELSH	SHENGJIN	BERAT	BULQIZE	PESHKOPI
		KAVAJE	BALLSH		GRAMSH	PUKE	HIMARE
		DIVJAKE	LUSHNJE		ROSKOVEC	DHERMI	TROPOJE
		RROGOZHINE	PATOS		BURREL	MALESI E MADHE	HAS
TRANSPORT	7.00%	8.00%	9.00%	10.00%	11.00%	12.00%	13.00%

(Kosto e kthimit nuk perfshin koston e montimit/ngjitjes se produktit te ri qe perzgjidhet)